



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË**

**Raporti i Akreditimit Institucional
të “Tirana Esthetics & Style School”**

Janar 2020

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1. Prof. As. Ana Kapaj Mane Kryetare

2. Prof. As. Erika Melonashi Anëtare

Tabela e përmbajtjes

Rreth këtij Vlerësimi	4
Konteksti i këtij vlerësimi	5
Raporti përmbledhës.....	6
Përmbledhje e gjetjeve.....	8
Rekomandime.....	9
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	9
Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi	9
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	10
Gjetje	12
Rekomandime.....	12
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	12
Gjykimi.....	12
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	13
Gjetje	14
Rekomandime.....	15
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	15
Gjykimi.....	15
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	16
Gjetje	17
Rekomandime.....	18
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	18
Gjykimi.....	18
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	19
Gjetje	20
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	20
Gjykimi.....	20
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	21
Gjetje	22
Rekomandime.....	22
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	22
Gjykimi.....	23
Lista e evidencave	23

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle “Tirana Esthetical & Style School” përmbush Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, të cilat hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve të huaj dhe shqiptarë, të caktuar nga ASCAL-i.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga “Tirana Esthetical & Style School”, por edhe për t’u ofruar palëve të interesit, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë janë grupuar nën pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë; standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar ASCAL-it dhe Këshillit të Akreditimit një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përpilimit të raportit, ASCAL-i ka siguruar ekspertë mbështetës për grupin e vlerësimit duke siguruar që grupi t’i mbështesë Gjetjet në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Tirana Esthetical & Style School (TESS) është një Institucion i Arsimit të Lartë Jopublik, në statusin e Kolegjit Profesional të Lartë, i cili ofron programe studimi 1-2 vjeçare pas arsimit të mesëm. TESS e ushtron veprimtarinë duke u mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 370, datë 26.04.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e kolegjit profesional të lartë”, në Statutin e këtij Kolegji, si dhe në të gjithë legjisllacionin tjetër në fuqi.

TESS është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 483, datë 31.07.2018 dhe është i organizuar në dy departamente: Departamenti i Estetikë-Nutricionit dhe Departamenti i Kozmetologjisë.

TESS ofron programe studimi profesionale, të cilat janë të licensuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Pas përfundimit të studimeve, studentët pajisen me një Diplomë Profesionale me 60 ose 120 Kredite ECTS.

- Profili i estetikës është një program 2-vjeçar. Programi i studimit për estetistët synon të krijojë profesionistë në fushën e estetikës. Roli kryesor i një estetisteje është të kujdeset për lëkurën, gjë e cila mund të arrihet duke pasur një profil të plotë 360 gradë rreth të gjitha njohurive teknike, informacionin e marrë nga studime shkencore, si dhe demonstrimet dhe orë praktikët në të gjitha disiplinat e kësaj fushe.
- Profili “Hair Artist” në “TESS” është një program dyvjeçar. Ky program synon të përgatisë profesionistë të fushës, duke ofruar një formim të plotë profesional. Programi përfshin njohuri që lidhen me anatominë, flokët, trikologjinë, si dhe njohuri rreth aftësive të nevojshme menaxheriale dhe atyre komunikuese për këtë fushë. Një domosdoshmëri për këtë fushë janë edhe njohuritë teorike, demonstrimet dhe praktikat lidhur me proceset e flokëve, siç janë trajtimet, lyerja dhe prerja, të cilat do të studiohen në profilin “Hair Artist”.
- Programi “Make-Up Artist” është krijuar për të mundësuar një formim të plotë dhe gjithëpërfshirës, me qëllim përfitimin e njohurive të nevojshme për profesionin e një make-up artist. Kjo gjë mund të arrihet duke maksimizuar aftësitë krijuese të studentëve dhe duke përforcuar talentin që ata kanë, në mënyrë që të jenë të qenë të përgatitur të plotësojnë të gjitha kërkesat si profesionistë të fushës në nivelet e kërkuara në industrinë e make up-it të ditëve të sotme. Programet përmbajnë leksione mbi rëndësinë e studimeve teorike, të kombinuara me demonstrime, si dhe praktika dhe projekte individuale.

Raporti përmbledhës

“Tirana Esthetical & Style School” (TESS) ka përpiluar raportin e vetëvlerësimit, i përgatitur nga ekipi i vetëvlerësimit. Ky i fundit përfshin stafin e nivelit të lartë, stafin akademik dhe atë administrativ, një ekspert të jashtëm dhe një student. Projekt-raportet e vetëvlerësimit (RVV) u qarkulluan në “TESS”, të cilat u finalizuan dhe u miratuan nga Rektori dhe Senati. Ky është procesi i parë i akreditimit për “TESS”, pas hapjes së tij në korrik të vitit 2018.

Në RVV u paraqit mënyra e funksionimit të IAL-së. Ky raport u mbështet nga evidenca, ndërsa përpara dhe gjatë vlerësimit u pajis edhe me më shumë evidenca të detajuara, të ofruara në anglisht dhe në shqip. Në përgjithësi, RVV-ja e ndihmoi Grupin e Vlerësimit të Jashtëm dhe mbi të grupi mbështeti vlerësimin që kreu.

Vizita e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm u krye brenda një dite. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë me përvojë në arsimin e lartë nga IAL-të në Shqipëri. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit të siguar nga ASCAL, agjencia përgjegjëse për vlerësimet e arsimit të lartë në Shqipëri. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me evidenca mbështetëse, disa javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë. Gjithsej, u morën në konsideratë mbi 80 dokumente, të cilat e ndihmuan grupin e vlerësimit të njihej me strukturën, politikën, procedurat e menaxhimit, ambientet dhe me veprimtaritë mësimore në “TESS”. Dokumentet e shqyrtuara përfshinin Statutin e IAL-së, Rregulloret Akadematike, procedurat e pranimit dhe orientimit të studentëve, gamën e marrëveshjeve të jashtme, shembuj të informacionit për programet dhe evidenca nga mbledhjet vendimmarrëse.

Në raport u shënuan gjykimet e mëposhtme për secilën zonë Vlerësimi:

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përmbushur kryesisht.**
2. Standardet për Burimet janë **përmbushur kryesisht.**
3. Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur kryesisht.**
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur plotësisht.**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përmbushur plotësisht.**

Vizita e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm u krye më 29 tetor 2019. Gjatë kësaj vizite, u organizuan një sërë mbledhjesh, që i mundësuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të kuptojë më qartë përgjegjësitë, procedurat, si dhe pikëpamjet e personelit dhe të studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Rektoren, stafin e nivelit të lartë, stafin akademik, stafin administrativ dhe atë mbështetës, alumnit, si dhe me përfaqësuesit e organizatave lokale dhe partnere. Në të gjitha mbledhjet e zhvilluara u mbajtën shënime. Si pjesë e vizitës së IAL-së, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi të gjitha ambientet, sallat e praktikës, hapësirat e mësimdhënies dhe ambientet administrative. Pas vlerësimit të të gjitha evidencave të vëna në dispozicion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimet e renditura në vijim.

“Tirana Esthetical & Style School” **i përmbush kryesisht standardet** për Organizimin dhe Menaxhimin e tij. Organizimi i Universitetit përcaktohet në Statutin dhe në Rregulloret e tij, dhe në mbledhjet zyrtare ndiqen procedura dhe protokolle të vendosura. “TESS” ka bërë mjaft përparime në përmbushjen e kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015. Sipas Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, “TESS” ka një bashkëpunim mjaft të ngushtë me institucionet private kombëtare dhe ndërkombëtare, për t’u siguruar studentëve mbështetjen e duhur gjatë trajnimit praktik, si dhe për punësimin e tyre në të ardhmen. Përpos kësaj, rekomandon që “TESS” të kryejë një studim të mirëfilltë të tregut, duke identifikuar nevojat për profesionin specifik.

“Tirana Esthetical & Style School” **i përmbush kryesisht** standardet për Burimet. Përgjegjësitë për burimet janë qartësisht të përcaktuara në Statutin dhe në Rregulloret e Kolegjit, si dhe përmbushen në mënyrë të përshtatshme nga Rektorati, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka konstatuar se “TESS” ndjek një politikë të hapur për rekrutimin e burimeve njerëzore, komunikimin dhe integrimin e suksesshëm të stafit administrativ dhe atij akademik, si dhe ka bërë një investim të lartë për të siguruar një infrastrukturë sa më moderne dhe profesionale. Përveç kësaj, rekomandon rritjen e përpjekjeve institucionale për të formalizuar, përmes dokumentacionit specifik, përdorimin e burimeve të larmishme dhe alternative të vlerësimit, në drejtim të performancës së stafit akademik dhe përmirësimit të komunikimit të brendshëm.

“Tirana Esthetical & Style School” **i përmbush kryesisht** standardet për Kurrikulën. Programet që ofron ky IAL përfaqësojnë misionin dhe objektin e tij për të ofruar trajnime, të cilat i pajisin profesionistët e ardhshëm me aftësi praktike në fushën e "Estetikës", "Hair artist" dhe "Make-up artist". Programet e studimit janë të mirëpërcaktuara, si dhe studentët marrin informacionin e përshtatshëm dhe në kohën e duhur. Një dobësi e konstatuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është mungesa e një strategjie të zhvillimit institucional për fillimin apo përfundimin e programeve të studimit, duke i rekomanduar “TESS” të ndërmarrë veprimet e nevojshme në këtë drejtim. Krahas kësaj, Grupi jep pohimin se “TESS” ka një plan strategjik institucional për periudhën 2018-2023.

“Tirana Esthetical & Style School” **i përmbush plotësisht** standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin. Në një kontekst ku Kolegji ofron kualifikime të nivelit 5 për specialistë teknikë, kërkimi shkencor i mirëfilltë nuk është pjesë e politikave të “TESS”. Krahas rritjes së aftësive krijuese dhe të zbatuara të studentëve, zhvillimi i programit të studimit deri në diplomim ofron njohuri të zbatuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të arritshme në tregun e punës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë, dobësi, rekomandime ose pohime.

“Tirana Esthetical & Style School” **i përmbush plotësisht** standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre. “TESS” u ofron studentëve udhëzim, këshillim, tutorim dhe mbështetje të formave të ndryshme. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi masat e marra për tekstet e librave, të cilat janë të përkthyer dhe të përshtatura në gjuhën shqipe nga pedagogët. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi disa karakteristika të praktikës së mirë, të tilla si java e organizimit dhe e orientimit për studentët e tij, mentorimi dhe këshillimi i vazhdueshëm i studentëve, përfshirja e kategorive specifike, përmes të cilave studentët krijojnë kontakte me tregun e punës, duke rritur kështu mundësitë për punësim të ardhshëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve sa i përket përfshirjes së tyre në jetën institucionale.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- “TESS” ka një bashkëpunim mjaft të ngushtë me institucionet private kombëtare dhe ndërkombëtare, për t’u siguruar studentëve mbështetjen e duhur gjatë trajnimit praktik, si dhe për punësimin e tyre në të ardhmen. **Kreu III Standardi III.3**
- Politikë e hapur për rekrutimin e burimeve njerëzore, si dhe kritere dhe procedura të mirëpërcaktuara. **Kreu III Standardi IV.1**
- Komunikim dhe integrim i suksesshëm i stafit administrativ dhe atij akademik në veprimtari të përbashkëta. **Kreu III Standardi IV.2**
- Investim në ofrimin e strukturës dhe ambienteve më moderne dhe profesionale në institucion. **Kapitulli III Standardi VII.5; Kapitulli III Standardi VII.6**
- Institucioni ka një mision të mirëpërcaktuar për të ofruar trajnime, të cilat i pajisin profesionistë e ardhshëm me aftësi praktike **Kapitulli I Standardi I.1**
- Objektivat e programeve të studimit janë të mirëpërcaktuara në **Kapitullin I, Standardi I.6**
- Kurrikula u ofron studentëve trajnim profesional dhe përgatitjen e duhur për t’u bërë pjesë e tregut të punës. **Kapitulli I Standardi I.11; Kapitulli I Standardi I.12**
- Programet e studimit të ofruara nga Institucioni lehtësojnë lëvizjen e studentëve drejt vendeve të tjera evropiane (si p.sh. Itali). **Kreu I Standardi I.10**
- Institucioni organizon një javë orientimi për studentët e rinj **Kapitulli I Standardi III.2**
- Institucioni u ofron studentëve mentorim dhe këshillim të vazhdueshëm **Kapitulli I Standardi III.3**
- Institucioni ka bërë përpjekje në drejtim të gjithëpërfshirjes së kategorive specifike (rregullimi i infrastrukturës; mbështetja me bursa) **Kapitulli I Standardi III**
- Institucioni organizon veprimtari të shpeshta profesionale, kulturore ose sportive për studentët, duke mundësuar kështu socializimin e tyre dhe kontakte të drejtpërdrejta me punonjësit e ardhshëm **Kapitulli I Standardi III.8**
- Instituti u siguron studentëve mundësi kontakti me tregun e punës, duke rritur kështu mundësitë për punësim në të ardhmen. **Kreu I Standardi III.9**

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Nuk është kryer asnjë studim tregu për të identifikuar nevojat për profesione specifike. **Kreu III Standardi III.1**
- Mungesa e dokumentacionit formal të duhur për të gjitha proceset specifike akademike/administrative. **Kreu III Standardi V.2**
- Vlerësimi i performancës së stafit akademik kryhet vetëm përmes një burimi: pyetësorët e studentëve **Kapitulli III Standardi IV.3**
- Nuk ka asnjë sistem qendror të menaxhimit të informacionit të brendshëm [intranet] ose një sistem të adresave të personalizuar të emailit për stafin dhe studentët. **Kreu III Standardi VII.2**
- Nuk ka asnjë strategji të zhvillimit institucional për fillimin dhe përfundimin e programeve të studimit. **Kreu I Standardi I.3**
- Studentët nuk janë të ndërgjegjësuar në lidhje me përfshirjen/përfaqësuesit e tyre brenda strukturave të ndryshme të institucionit **Kapitulli I Standardi III.7**

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Kryerja e studimit të mirëfilltë të tregut, duke identifikuar nevojat për një profesion specifik. **Kreu III Standardi III.1**
- Rritja e përpjekjeve institucionale në drejtim të formalizimit të të gjitha proceseve dhe procedurave në institucion përmes dokumentacionit specifik (minimizoni informalitetin). **Kreu III Standardi V.2**
- Përdorimi i burimeve të larmishme dhe alternative të vlerësimit jo vetëm të studentëve, por edhe për performancën e stafit akademik (p.sh. Vlerësim ndërmjet kolegëve, vlerësimi i përgjegjësit të departamentit etj.) **Kapitulli III Standardi IV.3**
- Përmirësimi i komunikimit të brendshëm dhe cilësisë së proceseve përmes krijimit të një sistemi qendror të menaxhimit të informacionit (si p.sh. intranet, adresat e emailit të institucionit etj.) **Kapitulli III Standardi VII.2**
- Propozimi i një strategjie të zhvillimit institucional për fillimin dhe përfundimin e programeve të studimit **Kapitulli I Standardi I.3**
- Rritja e ndërgjegjësimit të studentëve sa i përket përfshirjes së tyre në jetën institucionale (p.sh. organet e ndryshme si Senati, Këshilli i Etikës, Këshilli Studentor etj.) **Kapitulli I Standardi III.7**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- Tashmë, janë formalizuar një sërë procesesh dhe procedurash kyçe përmes dokumentacionit specifik **Kapitulli III Standardi V.2**
- Institucioni ka një plan strategjik për periudhën 2018-2023. **Kreu I Standardi I.3**
- “TESS” ka nisur të bëjë përpjekje në drejtim të pasurimit të bibliotekës shkollore. Pedagogët janë angazhuar me përkthimin dhe përshtatjen e teksteve shkollore në gjuhën shqipe. **Kreu I Standardi III.5**

Gjykime përmbljedhëse për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur kryesisht**
2. Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**
3. Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht**
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1** “Tirana Esthetical & Style School” është një Institucion i Arsimit të Lartë Jopublik, në statusin e Kolegjit Profesional të Lartë, i cili ofron programe studimi 1-2 vjeçare. Ky institucion është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 483, datë 31.07.2018 dhe është i organizuar në dy departamente: Departamenti i Estetikë-Nutricionit dhe Departamenti i Kozmetologjisë. “TESS” e ushtron veprimtarinë akademike bazuar në aktet ligjore dhe në statutin e tij, si dhe në të gjitha aktet e tjera të miratuara nga autoritetet dhe organet drejtuese të këtij institucioni. Statuti është dokumenti themelor që përcakton normat dhe rregullat bazë të funksionimit dhe veprimtarive të “TESS”, në përputhje me misionin, vizionin dhe objektivat e tij. Statuti është përpiluar bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Statuti u miratua më 23/08/2018, bazuar në Urdhrin Nr. 512 të Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë për “Miratimin e Statutit të Kolegjit të Lartë Profesional “TESS” [1.1, M1]. Veprimtaritë e përditshme të “TESS” zhvillohen në përputhje me Rregulloren e tij të brendshme [1.3]. Statuti i “TESS” është në proces rishikimi. Bazuar në vendimin nr. 10 të Senatit Akademik më 14.02.2019, për rishikimin e Statutit u caktua një grup pune. [1.2, RVV fq. 9] **Kapitulli III Standardi I.1**
- 1.2** Organizimi dhe menaxhimi i “TESS” sigurohet përmes organeve vendimmarrëse, si dhe kryhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, Ligjin Nr.80/2015 dhe Vendimin Nr. 370, datë 26.04.2017. Organet më të larta vendimmarrëse janë Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, të cilat mundësojnë administrimin e veprimtarisë akademike dhe financiare të kolegjit. [1.4, 1.5, M2, M6] Strukturat e tjera akademike dhe organet drejtuese administrative të “TESS” funksionojnë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Senati Akademik, si organi më i lartë vendimmarrës i kolegjit, përcakton planifikimin më të rëndësishëm strategjik të institucionit në fushat e mësimdhënies, si dhe jep miratimin e tij për çështjet administrative dhe ato financiare. Ky organ funksionon në përputhje me Statutin e “TESS”, i cili përcakton të gjitha kompetencat e tij [1.1, 1.2]. Senati mbledhet në mënyrë periodike, duke nxjerrë vendimet e tij përkatëse. **Kapitulli III Standardi I.2**
- 1.3** Organet kolegjinale të “TESS” takohen periodikisht, në përputhje me dispozitat e rregulloreve specifike për funksionimin e tyre. Senati, si organi kolegjal më i lartë akademik i Kolegjit, e ushtron veprimtarinë duke organizuar mbledhje të rregullta [1.5, 1.6, M2]. Senati Akademik i kryen funksionet e tij në bashkëpunim me organet e tjera kolegjinale të “TESS”. Ai bashkëpunon me Bordin e Administrimit dhe organet e tjera kolegjinale për miratimin e statutit dhe rregulloren e Kolegjit, planifikimin strategjik të mësimdhënies, buxhetin e “TESS” etj. Përpos kësaj, Bordi i Administrimit, si organi përgjegjës për administrimin financiar të institucionit, bashkëpunon me Senatin Akademik për hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor dhe buxhetit afatmesëm, bazuar në propozimet e bëra nga njësitë kryesore dhe njësitë bazë, për planin strategjik për zhvillimin institucional, si dhe për programin buxhetor afatmesëm [1.4, 1.5, M2, M6]. Bordi i Administrimit përbëhet nga 3 ekspertë të jashtëm, në përputhje me Vendimin Nr.370, datë 26.04.2017. [M6] Vendimet e marra nga këto organe (Senati Akademik, Rektorati, Bordi i Administrimit) protokollohen dhe u kalohen strukturave përkatëse për zbatim, në përputhje me objektin e vendimit. Departamenti është njësi bazë që mundëson dhe kryen diskutime konstruktive ndërmjet anëtarëve të stafit akademik. Gjatë mbledhjes së departamentit, e cila drejtohet nga përgjegjësi i departamentit, adresohen çështje të tilla si: detyrat e mësimdhënies, programi i studimit, si dhe marrëdhënia me studentët. [M2, M5]. **Kreu III Standardi I.3**
- 1.4** TESS funksionon në përputhje me bazën ligjore në fushën e arsimit të lartë, në sipas së cilës ka hartuar rregulloren e brendshme, e cila garanton autonominë e jashtme dhe të brendshme të institucionit. Autonomia e brendshme sigurohet nga Statuti dhe Rregulloret e

brendshme të Kolegjit, të cilat përcaktojnë rregullat organizative dhe funksionuese të institucionit dhe vlerësimet periodike institucionale. “TESS” ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillin e Etikës [1.2, 1.3, 1.4, 1.6], e cila monitoron kufijtë e autonomisë akademike dhe asaj administrative. Njësia e Sigurimit të Brendshëm e Cilësisë, një strukturë e pavarur brenda “TESS”, është një nga mekanizmat e krijuara për të siguruar dhe garantuar mbikëqyrje dhe vlerësim të brendshëm. [1.8] **Kapitulli III Standardi I.4**

1.5 Në përgjigje të detyrimeve të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, “TESS” ndjek strategjinë e tij të zhvillimit institucional për periudhën 2018-2023. Strategjia e Zhvillimit përcakton misionin dhe vizionin kryesor. Megjithatë, objektivat e ardhshme të institucionit, të cilat kërkojnë zhvillim të mëtejshëm, të tilla si: kërkimi, ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti, stafi dhe infrastruktura, ende mungojnë në këtë strategji të mirëplanifikuar. Në këtë strategji, “TESS” duhet të shpjegojë masat e nevojshme për të përmbushur objektivat strategjike, në përputhje me misionin, objektivin dhe platformën e zhvillimit dhe financimin e përshkruar në këtë dokument. [1.9] **Kapitulli III Standardi I.5**

1.6 Në përputhje me nenin 32 të Ligjit nr. 80/2015, të gjitha institucionet e arsimit të lartë i paraqesin ministrisë kompetente, për çdo vit akademik, raportet vjetore për veprimtaritë e tyre, gjendjen e tyre financiare, parashikimet e angazhimit të stafit akademik, si dhe tarifat e shkollës për vitet në vijim. “TESS” është një institucion i ri, i hapur prej më pak se 1 viti. Kolegji ka punuar për përgatitjen e raportit vjetor, por ende nuk e keni dorëzuar atë, kjo pasi nuk është përmbushur afati kohor për dorëzimin e raportit të parë vjetor në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. [RVV, fq. 11, 1.13] **Kapitulli III Standardi I.6**

1.7 Përmes organizimit të tij, “TESS” ofron liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe personale në përzgjedhjen e personelit, në përputhje me legjisllacionin në fuqi. “TESS” organizohet në 2 departamente: Departamenti i Estetikë-Nutricionit dhe Departamenti i Kozmetologjisë. [RVV, fq. 7, 1.4] Ky institucion ofron vetëm programe të ciklit të parë. “TESS” ka faqen e tij të internetit, e cila jep informacion rreth programeve të ofruara të studimit etj. [https://www.tess.al] **Kapitulli III Standardi II.1**

1.8 Organet drejtuese të “TESS” janë si më poshtë: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Asambleja e Stafit Akademik, Këshilli i Etikës dhe Rektorati. Këto organe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe marrin vendime të rëndësishme ose japin rekomandime për veprimtarinë e “TESS” dhe të njësive themelore të tij (departamenteve), sipas statutit dhe dispozitave të rregulloreve. [1.3, 1.4, 1.5, 1.6] **Kapitulli III Standardi II.3**

1.9 Pas përfundimit të studimeve, “TESS” përpaket të monitorojë punësimin e të diplomuarve të tij. Megjithatë, ky është një institucion i ri dhe nuk ka një bazë të dhënash. [M1] **TESS nuk ka kryer një studim tregu** për t’i ndihmuar të sapodiplomuarit të përcaktojnë përparësitë në programet e reja të studimit, duke u bazuar në nevojat e rajonit. Kjo përbën një dobësi të institucionit, prandaj EVJ-ja rekomandon realizimin e një studimi të mirëfilltë të tregut në të ardhmen. [M1] **Kapitulli III Standardi III.1**

1.10 Për t’u ofruar studentëve shërbime si pjesë e praktikës së tyre profesionale, “TESS” bashkëpunon me një sërë institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare. Përpos kësaj, gjatë mbledhjeve me studentët, alumni dhe partnerët, është konstatuar **një bashkëpunim mjaft i ngushtë midis “TESS” dhe këtyre institucioneve private**. Kjo është një karakteristikë e praktikës së mirë të Kolegjit. [M4] **Kapitulli III Standardi III.3**

Gjetje

Praktika e mirë

- “TESS” ka një bashkëpunim mjaft të ngushtë me institucionet private kombëtare dhe ndërkombëtare, për t’u siguruar studentëve mbështetjen e duhur gjatë trajnimit praktik, si dhe për punësimin e tyre në të ardhmen. **Kreu III Standardi III.3**

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Nuk është kryer një studim tregu për të identifikuar nevojat për profesione specifike. **Kreu III Standardi III.1**

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Kryerja e studimit të mirëfilltë të tregut, duke identifikuar nevojat për një profesion specifik. **Kreu III Standardi III.1**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

- Nuk u gjetën pohime

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 Në lidhje me Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, pas ekzaminimit të kujdesshëm të RVV-së, dokumenteve mbështetëse dhe mbledhjeve me stafin akademik dhe administrativ të institucionit, GVJ-ja konfirmon se "TESS" ndjek një politikë të hapur për rekrutimin e burimeve njerëzore. Politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore janë të rregulluara përmes një dokumenti specifik [2.1], ndërsa vendet e lira të punës publikohen në faqen e internetit [2.2]. Instituti përdor kritere të mirëpërcaktuara për vlerësimin/rekrutimin e kandidatëve, të tilla si: Përvoja e punës/mësimdhënës në nivel universitare apo kolegjal profesional, etikën dhe aftësitë e komunikimit, planet për karrierë, njohja e gjuhëve të huaja etj. Gjithashtu, i gjithë procesi i rekrutimit dhe i përzgjedhjes është i dokumentuar dhe i finalizuar me një rezolutë rekrutimi [2.3]. **Kreu III Standardi IV.1**

2.2 Në lidhje me politikat integruese të stafit akademik dhe administrativ, menaxhimi i burimeve njerëzore konsiderohet gjithashtu i suksesshëm, aspekt i cili lehtësohet ndjeshëm nga përmasat e vogla të institucionit. GVJ-ja evidentoi një sërë veprimtarish dhe aktivitetsesh të përbashkëta, të cilat kontribuojnë në përforcimin e kësaj qasjeje (trajnime, workshop-e, ditë të hapura, ditë informimi etj.) [2.5]. **Kapitulli III Standardi IV.2, Kapitulli III Standardi IV.4**

2.3 Përveç kësaj, në vijim të vizitës në institucion dhe mbledhjeve me stafin akademik dhe administrativ, VLG-ja konfirmon se bashkëpunimi/komunikimi është i shpejtë dhe i lehtë në nivele të ndryshme. Përshkrimi i punës është i qartë për çdo pozicion administrativ dhe akademik, sikurse shprehet në Rregullore dhe Kontratën e punës [1.1; 1.3; 2.7; 2.8]. Sipas GVJ-së, ky aspekt lehtëson procesin e komunikimit dhe eliminon paqartësitë rreth detyrave/përgjegjësi. Megjithatë, procesi tejet u suksesshëm i komunikimit, i ndikuar pozitivisht nga përmasat e vogla të institucionit, shoqërohet edhe nga një efekt negativ, e thënë ndryshe, mungesa e dokumentacionit zyrtar të regjistrimit të proceseve/procedurave. **Kreu III Standardi II.2**

2.4 Në lidhje me vlerësimin e performancës, GVJ-ja evidentoi se informacioni bazë për vlerësimin e aftësive të stafit vjen nga vlerësimet e studentëve [4.7]. Megjithatë, nuk ka asnjë evidencë për vlerësimin e aftësive nga burime të tjera (si p.sh. vlerësimi nga kolegët, përgjegjësi i departamentit etj.). Pavarësisht kësaj, çmimet e stafit për performancë të mirë [RVV, fq.18], mund të konsiderohen si një lloj feedback-u, ndonëse procesi përmes të cilit ata janë zgjedhur nuk është i qartë. **Kreu III Standardi IV.3**

2.5 Në lidhje me menaxhimin financiar të institucionit. GVJ-ja konfirmon se Institucioni përgatit një raport vjetor për veprimtarinë, i cili përmban një vlerësim mbi realizimin e planit të buxhetit, si dhe një analizë të situatës financiare [2.4]. Sikurse pasqyrohet në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe konfirmohet gjatë vizitës në institucion, autoritetet/strukturat përgjegjëse për menaxhimin financiar të institucionit përfshijnë Administratorin, Zyrën e Financës dhe Themeluesin e kolegjit. **Kreu III Standardi IV.1**

2.6 Buxheti vjetor miratohet nga Bordi i Administrimit dhe Senati akademik në fillim të çdo viti akademik [1.1; 2.4; 2.9]. GVJ-ja konfirmon transparencën në lidhje me alokimin e burimeve brenda institucionit. Të gjitha transaksionet financiare, duke përfshirë pagesat e tarifave të studentëve, kryhen përmes llogarive bankare të kompanisë, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës [2.4; 2.9]. Përpos kësaj, Institucioni i nënshtrohet një auditimi të jashtëm financiar vjetor, proces i cili përfundon me përpilimin e një raporti auditimi që vlerëson pajtueshmërinë me legjislacionin ekzistues të menaxhimit financiar. Megjithatë, duke marrë parasysh përmasat e të vogla të institucionit dhe numrit mjaft të kufizuar të studentëve, nëse nuk ka burime të tjera financiare përveç tarifave të shkollimit (p.sh.

projekte kombëtare/ndërkombëtare etj.), qëndrueshmëria financiare e institucionit është e diskutueshme. **Kapitulli III Standardi VI.3; Kapitulli III Standardi VI.3**

2.7 Në lidhje me Sistemin e menaxhimit të informacionit, GVJ-ja konfirmon se Instituti “TESS” ka një faqe interneti, www.tess.al, e cila përmban informacion bazë rreth institucionit (si p.sh. organizimin e tij, rregulloret) dhe programet e studimit. Institucioni ka një bazë të dhënash me informacion mbi regjistrimin, matrikullën, programin e studimit, notat etj. të studentit; sekretaria është përgjegjëse për mirëmbajtjen e këtij informacioni në format elektronik dhe të shtypur. Gjithashtu, sekretaria mban regjistrat e studentëve, si dhe mban përgjegjësi për plotësimin dhe ruajtjen e tyre [2.16; 2.17]. Informacioni për proceset e përfunduara/të kaluara ruhet në format të shtypur dhe elektronik në Arkivën e Institucionit, i cili ruan informacione nga e kaluara sipas një rregulloreje të veçantë [2.13]. **Kreu III Standardi VII.1**

